**VENDIM**
**Nr. 765, datë 2.11.2016**

# PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 663, DATË 17.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE TË PALIGJSHME DHE TERRORIZMIT, 2013 -2020, DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITET 2013-2016", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet shtojca 2, me titull "Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2016-2020", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Shërbimi Informativ Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
**Niko Peleshi**

SHTOJCË 2

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT DHE PLANI I VEPRIMIT
2016-2020

## Lista e Shkurtimeve

| | |
|---|---|
| AAC | Autoriteti i Aviacionit Civil |
| AAPS | Agjencia e Administrimit të Aseteve Kriminale |
| ADM | Armë të Dëmtimit në Masë |
| AISM | Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes |
| AKSHE | Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve |
| ANEA | Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike |
| BSH | Banka e Shqipërisë |
| CBRN | Armë të Shkatërrimit në Masë |
| DA | Drejtoria e Antiterrorit |
| DIH | Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor |
| DKEF | Drejtoria e Krimit Ekonomiko Financiar |
| DPB | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| DPD | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave |
| DPEC | Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile |
| DPKM | Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit |
| DPKOKR | Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e K. Organizuar & K. Rënda |
| DPPPP | Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave |
| DPRSP | Drejtoria e Përgjithshme e Rendit dhe për Sigurinë Publike |
| DPSH | Drejtoria e Policisë se Shtetit |
| DPSHTRR | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor |
| DPT | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| FA | Forcat e Armatosura |
| FSP | Forca e Sigurisë Portuale |
| IFB | Instituti i Fizikës Bërthamore |
| FAj | Komanda e Forcës Ajrore |
| KFD | Komanda e Forcës Detare |
| KFT | Komanda e Forcave Tokësore |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KMR | Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet |
| MAS | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| MBZHRAU | Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave |
| MD | Ministra e Drejtësisë |
| ME | Ministria e Energjisë dhe Industrisë |
| MF | Ministra e Financave |
| MMj | Ministra e Mjedisit |
| MMb | Ministria e Mbrojtjes |
| MMSR | Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë |
| MPB | Ministra e Punëve të Brendshme |
| MPJ | Ministria e Punëve të Jashtme |
| MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MTI | Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës |
| MZHETTS | Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes |
| PKR | Prokuroria e Krimeve të Rënda |
| PP | Prokuroria e Përgjithshme |
| PU | Policia Ushtarake |
| SSK | Strategjia e Sigurisë Kombëtare |
| SHISH | Shërbimi Informativ i Shtetit |
| ZMR | Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi |

# HYRJE

Republika e Shqipërisë jep një kontribut të çmuar për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe qëndron në mënyrë të vendosur në luftën kundër terrorizmit.
Shqipëria që prej vitit 2001, është anëtare e koalicionit kundër terrorizmit në mbarë botën dhe ka mbështetur aleatët dhe partnerët e saj që nga fillimi i luftës së përbashkët kundër terrorizmit ndërkombëtar. Si pjesë e përpjekjeve të këtij koalicioni në luftën kundër terrorizmit, Shqipëria renditet ndër vendet me kontribute konkrete si dhe mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar në përpjekjet globale për të ruajtur paqen dhe sigurinë në botë.

Terrorizmi në të gjitha format dhe manifestimet e tij përbën një kërcënim serioz për paqen dhe sigurinë në botë, siç përcaktohet në Rezolutën e KSOKB-së 1269 (1999). Për këtë arsye, shteti shqiptar e ka konsideruar luftën kundër terrorizmit si një prioritet kombëtar dhe ka ndërtuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional për të parandaluar dhe për të luftuar kërcënimin e terrorizmit ndaj sigurisë kombëtare. Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar të gjitha konventat dhe protokollet e OKB-së dhe të Këshillit të Europës në lidhje me luftën kundër terrorizmit. Gjithashtu, ka bashkë-sponsorizuar Rezolutën 2178/2014(*lidhjen midis ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit*) të Këshillit të Sigurimit dhe ka nënshkruar Protokollin Shtesë të Konventës Europiane për Parandalimin e Terrorizmit (2015), i cili adreson fenomenin e luftëtarëve të huaj.

Shqipëria ka ndërmarrë dhe përforcuar hapa të rëndësishme për parandalimin dhe goditjen e financimit të aktiviteteve terroriste.

Shqipëria ka tashmë një legjislacion të plotë dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare në këtë fushë. Shqipëria gjithashtu është hequr nga lista e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës me rrezik potencial për financimin e terrorizmit. Janë përcaktuar kompetencat dhe marrëdhëniet e organeve përgjegjëse për propozimin, miratimin, kontrollin dhe zbatimin e detyrimeve që lindin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (më të rëndësishme të UNSCR 1373/2001 dhe 2253/2015), si dhe detyrimi për raportim të rasteve të dyshimta për financim të terrorizmit nga subjektet, institucionet dhe çdo person që disponon një informacion të tillë.

Shqipëria zbaton brenda afateve ligjore dhe miraton listat e publikuara nga Këshilli i Sigurimit për individët dhe organizatat që financojnë terrorizmin dhe ka miratuar, masa legjislative konkrete kundër personave dhe organizatave të listuara në këto lista.
Në zbatim të rekomandimeve të Strategjisë Globale të OKB-së kundër Terrorizmit, zhvillimi i strategjive gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar është thelbësor për të luftuar në mënyrë efektive kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Shqipëria ka shqyrtuar dhe miratuar në Korrik 2014, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhenë Nëntor 2015, miratoi Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, që harmonizon energjitë dhe angazhimin e shtetit shqiptar dhe vendosmërinë e qeverisë, shoqërisë civile dhe komuniteteve fetare, për ta bërë luftën tonë kundër ekstremizmit të dhunshëm një përpjekje suksesi të përbashkët. Strategji të tilla janë të rëndësishme jo vetëm për luftimin e radikalizmit dhe të rekrutimit, por edhe për të vlerësuar siç duhet mundësinë e ri-integrimit.
Qeveria shqiptare synon që nëpërmjet Strategjisë Kombëtare kundër Terrorizmit të harmonizojë veprimet e strukturave, agjencive dhe institucioneve të ndryshme të cilat kanë në përgjegjësitë e tyre institucionale luftën kundër terrorizmit. Dokumenti i propozuar mbështetet në Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit, e cila për t'ju përgjigjur sfidave të terrorizmit, bazohet në 4 shtylla veprimi: parandalimi, mbrojtja, ndjekja dhe reagimi.
Strategjia, me shtrirje kohore 2016–2020, synon:

- të identifikojë gjerësisht fenomenin e krimit të terrorizmit dhe fenomenet e tjera që rrjedhin prej tij, duke analizuar shkaqet e faktorët e tij;
- të evidentojë dhe dokumentojë veprimtarinë institucionale të të gjithë aktorëve që marrin detyrime për luftën kundër krimit të terrorizmit;
- të përcaktojë situatën aktuale ku ndodhet vendi ynë dhe masat për ndjekjen, parandalimin,
- mbrojtjen dhe reagimin ndaj këtij fenomeni;
- të shpallë objektivat për zbulimin dhe parandalimin e terrorizmit, si dhe masat për realizimin e tyre;
- të planifikojë e tregojë rrugët e implementimit të strategjisë;
- të evidentojë nevojat financiare apo burimet e mundshme financiare për realizimin e detyrimeve në funksion të implementimit të kësaj strategjie.

Strategjia Kombëtare kundër Terrorizmit është hartuar në harmoni me dokumentet e ngjashme dhe më të rëndësishme ndërkombëtare. Kjo strategji plotëson detyrimin që rrjedh nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare për hartimin e strategjive sektoriale dhe është komplementare me:

- Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm2016-2020.
- Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013 – 2020.
- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2014-2020.
- Strategjia e Luftës Kundër Trafikimit të Personave 2014-2017.
- Strategjia Kombëtare Kundër Drogës 2012-2016.
- Strategjia e Rendit Publik (Programi për Policinë e Shtetit) 2014–2020.

Bashkërendimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Terrorizmit me strategjitë e tjera kombëtare e sidomos me atë kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve të Paligjshme etj, është i një rëndësie të veçantë pasi që në shumë vende është vërejtur një trend i afrimit

të organizatave terroriste me organizatat kriminale. Përmes krimit të organizuar e sidomos pastrimit të parave, iu mundësohet terroristëve të fshehin dhe legjitimojnë produktet e krimit. Trafikimi me drogë dhe kultivimi i drogës u ofron terroristëve burim të vlefshëm të të ardhurave të cilat ata i shndërrojnë në fonde për qëllime trajnimi të terroristëve, sigurimin e pajisjeve logjistike dhe teknologjinë, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme.

## KREU I

### 1. ANALIZA E SITUATËS

#### 1.1. Situata e rrezikut të terrorizmit dhe ekstremizmit në vend

Terrorizmi është një fenomen që zhvillohet në kontekste të caktuara dhe motivohet nga një shumëllojshmëri konfliktesh të brendshme ose të jashtme që motivojnë grupin terrorist dhe mbështetësit e tij. Veprimtaritë terroriste gjejnë terren dhe lehtësohen nga disponueshmëria e financimit dhe streha e sigurt (safe heaven), sponsorizimi shtetëror dhe strukturat e dobëta të sigurisë. Duke pasur në konsideratë këto parakushte Shqipëria është një vend me risk të ulët për sulme terroriste, por gjithsesi fenomeni kërkon një analizë të veçantë.

Vlerësohet se grupet terroriste ndërkombëtare nuk kanë mundur deri tani të shtrijnë rrjetet e tyre në Shqipëri, gjithsesi vendi ynë nuk mund të përjashtohet nga ky rrezik dhe për vetë pozitën e favorshme gjeografike, ekziston mundësia të përdoret si strehë apo tranzit për grupe të tilla. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë krijon kushte që vendi të synohet si një pikë tranzitimi, jo vetëm i trafiqeve dhe i aktiviteteve të paligjshme, por edhe për përhapjen e sindromës së terrorizmit, *(Krijimin e kushteve për përhapjen e ideologjisë së ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit)* veçanërisht atij me element ekstremist shqiptare.

Në Shqipëri ekzistojnë grupe dhe individë që përhapin dhe përkrahin ide radikale dhe ekstremiste me veshje fetare. Këto grupe dhe individë shpeshherë ndikohen nga elemente fetarë të importuar nga vendet e Lindjes përmes përhapjes së ideve dhe përkrahjes së ideologjive radikale islamike të luftës së shenjtë apo "xhihadit" kundër perëndimit dhe SHBA-së. Këta individë dhe grupe aktivitetin e tyre e zhvillojnë kryesisht jashtë kontrollit të Komunitetit Mysliman Shqiptar.

Ekstremistët kanë për qëllim të zhdukin tolerancën tonë fetare të kultivuar ndër shekuj. Ata synojnë të zhdukin mësimet fetare jashtëzakonisht tolerante dhe racionale dhe t'i zëvendësojnë ato me mësime tepër ekstremiste. Këto aktivitete ushtrohen përmes shoqatave dhe organizatave të ndryshme, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, të cilat

marrin për sipër indoktrinimin e njerëzve në pikëpamje fetare, duke e përhapur ideologjinë radikale, gjë që nuk i përket traditës fetare të predikuar me shekuj në vend.

Organizata të tilla e ushtrojnë aktivitetin, duke u kamufluar përmes ndihmës ekonomike/financiare kryesisht për shtresën e varfër e të paarsimuar të shoqërisë, në të cilën ka mundësi më të madhe të ndikimit dhe manipulimit. Ato organizojnë debate dhe takime të ndryshme publike në xhami dhe faltore të improvizuara. Në ligjërata kryesisht diskutohen tema me karakter fetar, por me një dozë të theksuar ekstremizmi. Po ashtu organizohet shpërndarja e literaturës radikale falas, krijimi i faltoreve të improvizuara nëpër objekte private, organizimi i kurseve të ndryshme për indoktrinim fetar, krijimi i konvikteve/shtëpi private për studentët e "zellshëm", të cilët përdoren më tej për veprimtari propagandistike.

Shqetësim paraqet fakti që disa shtetas të Shqipërisë, Kosovës etj., të indoktrinuar me ideologji ekstremiste, janë organizuar në grupe terroriste dhe janë shprehur apo edhe kanë planifikuar kryerjen e akteve terroriste në rajon. Ekziston një shqetësim nga shtete të BE-së për individë të caktuar në rajon që konsiderohen si ekstremistë të dhunshëm dhe paraqesin rrezik potencial edhe për sigurinë e shteteve të tjera.
Shqipëria bashkëpunon në platforma të ndryshme me vendet e rajonit për adresimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe fenomenit të luftëtarëve të huaj. Duhet theksuar fakti se në trajtimin e aspekteve të këtij karakteri dhe veçanërisht kur ndodhin akte kriminale, në të cilën gjenden të përfshirë edhe elemente shqiptare, ky faktor konsiderohet një i tërë, duke mos bërë dallim së cilës pjesë të trojeve etnike i përket.

Disa nga faktorët që ndikuan në përhapjen graduale të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri janë:

- Futja në Shqipëri e personave të pakontrolluar dhe ekstremistë, kryesisht nga vendet arabe, të cilët nën petkun fetar ndikuan në përhapjen e rrymave të ndryshme ekstreme;
- Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për rrezikshmërinë dhe pasojat e terrorizmit dhe ekstremizmit;
- Niveli i ulët ekonomik, veçanërisht në shtresa të caktuara që shërbyen si ambiente për përhapjen dhe përqafimin e fenomeneve ekstremiste;
- Pozicioni gjeostrategjik i vendit tonë, i vendosur në udhëkryqet midis lindjes dhe perëndimit;
- Nivel i ulët i reagimit të institucioneve të shtetit, për të vlerësuar e parandaluar lindjen e fenomenit të ekstremizmit në Shqipëri;
- Mungesa e kuadrit të plotë ligjor, strukturor dhe infrastrukturës së nevojshme për të luftuar me cilësi këto fenomene;
- Mungesa e eksperiencës dhe e bashkëpunimit me partnerët dhe aleatët për të siguruar ekspertizën e nevojshme në këtë fushë.

Gjithashtu, në vendin tonë janë evidentuar raste që iniciojnë probleme të lidhura me ekstremizmin, si:

- Evidentimi i shtetasve shqiptare të përfshirë gjatë vitit 2012 e në vazhdim në konflikt të armatosur në Siri/Irak, ku disa prej tyre vazhdojnë të luftojnë, disa janë vrarë, si dhe një pjesë janë kthyer në Shqipëri.
- Evidentimin e organizatave, financimeve, shoqatave dhe strukturave të ngritura në vendin tonë, mekanizmin e tyre funksional, disa mënyra financimi donatorësh, rrugët e realizimit të tyre, si dhe kodifikimet e bëra;
- Individë në listën e sanksioneve të OKB-së, sipas rezolutës 2253 (2015) për të cilët kemi vepruar për interesat tona dhe për ata me aktivitet jashtë Shqipërisë duke bashkëpunuar me shërbimet partnere;
- Investigimet për pasuritë që kanë shtetasit e huaj në vendin tonë, të cilat mund të rrjedhin nga burime të dyshimta apo organizata terroriste. Për vitin 1996 e në vazhdim, janë arrestuar dhe çuar në gjykim disa organizata kriminale, të cilat në përmbajtjen e tyre kriminale kanë përgatitur dhe kryer edhe akte të mprehta kriminale të cilësuara "terroriste".

### 1.2. Masat kundër Terrorizmit

#### 1.2.1. Përkufizimi i krimit të terrorizmit sipas legjislacionit shqiptar

Në legjislacionin shqiptar, përkatësisht në nenin 28 të Kodit Penal, jepet ky përcaktim për organizatat kriminale:
1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Organizata kriminale, për realizimin e qëllimeve të saj, përdor forcën, mjetet e tjera të kërcënimit, nënshtrimit dhe heshtjen për shkak të pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së saj, për të kryer vepra penale, për të siguruar, në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarisë ekonomike, të koncesioneve, autorizimeve, sipërmarrjeve dhe shërbimeve publike, për të realizuar përfitime ose avantazhe të padrejta për vetë a personat e tjerë.
2. Organizata terroriste është formë e veçantë e organizatës kriminale, që synon kryerjen e veprimeve të dhunshme për qëllime terroriste, si përmbysje të rendit kushtetues, turbullim të rëndë të rendit publik, ngjallje të frikës dhe pasigurisë në masë.
3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarake dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V,VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi.

4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale.
5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta.

6. Anëtarët e organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë se tyre kriminale.

7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtim nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejt ose prej tyre, si edhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuara kriminale. Në vitin 2008 u ndryshua neni 230 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë duke u shprehur më qartë për vlerësimin dhe sanksionet ndaj organizimeve dhe fenomeneve që lidhen me terrorizmin".

### 1.2.2. Masat kundër financimit të terrorizmit

Në kuadër të masave të luftës kundër terrorizmit, pas daljes së rezolutës nr.1267 të datës 15 tetor 1999, të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe pas adoptimit të saj dhe miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", janë kryer sekuestrimet e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) të disa shtetasve të huaj të dyshuar për financim të terrorizmit.

Në mbështetje të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për luftën kundër financimit të terrorizmit" viti 1999, e ratifikuar me ligjin nr.8865, datë 14.3.2002; të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", janë kryer sekuestrimet e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet), si më poshtë:

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të shtetasit Arab Asin Al-Qadi.
- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të Fondacionit "Ringjallja e Trashëgimisë Islame" (Revival Of Islamic Heritage Society-RIHS).

- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit "Al Haramania".
- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të fondacionit "Taibah Internacional", i njohur dhe si "Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave".
- Për sekuestrimin e pasurive, llogaritë, investimet dhe asetet e shtetasit Abdul Latif Saleh.
- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari të shtetasit Nabil Abdyl Sayadi.
- Për sekuestrimin e pasurive (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të Fondacionit "Global Relief Foundation" (GRF).

Si rezultat i masave të marra vendi ynë është hequr nga lista e vendeve problematike për financimin e terrorizmit në vitin 2015. Vendi ynë ka tashmë një legjislacion të plotë për parandalimin dhe goditjen e financimit të terrorizmit, që është në harmoni me standardet ndërkombëtare. Janë përcaktuar kompetencat dhe marrëdhëniet e organeve përgjegjëse për propozimin, miratimin, kontrollin dhe zbatimin detyrimeve që lindin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe detyrimi për raportim të rasteve të dyshimta për financim të terrorizmit nga subjektet, institucionet dhe çdo person që disponon një informacion të tillë.

### 1.2.3.Masat kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Ekstremizmi i dhunshëm e radikalizmi, janë motivet kryesore që shtyjnë persona të caktuar në planifikimin dhe ekzekutimin e akteve terroriste dhe përhapjen e mesazheve të nxitjes së urrejtjes ndërfetare, prandaj këto motive përbëjnë një kërcënim që mund të konsiderohet serioz. Kësisoj, lufta kundër këtyre kërcënimeve, pavarësisht se ku ndodhin apo nga kush vijnë, kërkon që aktorët e ndryshëm qeveritarë të forcojnë bashkëpunimin në nivel kombëtar, si dhe atë rajonal e global.

Në konceptimin e një kundërpërgjigjeje shqiptare ndaj ekstremizmit të dhunshëm, Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (2016) do të mbetet platforma e përbashkët për të gjitha përpjekjet e ardhshme në vend. Për më tepër, Shqipëria do të vijojë të mbështetë fort përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit, ndërkohë që garanton të drejtat e njeriut dhe forcon shtetin e së drejtës. Shqipëria është e angazhuar që të japë një kontribut thelbësor e të prekshëm në përpjekjet ndërkombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

Qeveria shqiptare në mbështetje të përpjekjeve globale dhe nismave të OKB-së për implementimin e masave kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është sensibilizuar lidhur me kërcënimet që mund të paraqiten për sigurinë e vendit nga

ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi dhe për këtë qëllim janë ndërmarrë disa masa ligjore dhe operacionale në kuadër të luftës kundër terrorizmit si:

- Miratimi i ligjit "Mbi ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit të shtetasve shqiptarë", i cili ka hyrë në fuqi më 3 shtator 2014 dhe parashikon masa të rënda dënimi. Ky ligj parashikon dënime 3-8 vjet burg për pjesëmarrjen në konflikte sipas nenit 265/a, 5-10 vjet kur kjo vepër kryhet me qëllim përmbysjen e rendit kushtetues ose shkeljen e integritetit territorial të një shteti të huaj dhe 8-15 vjet për nxitjen, rekrutimin, organizimin, drejtimin, stërvitjen, vënien në dispozicion të pajisjeve, krijimin ose përdorimin e fondeve a mjeteve të tjera për financimin, mbështetjen materiale, në çdo lloj forme e mënyre për të kryer veprën penale të parashikuar nga neni 265/a. Po kështu, neni 265/c, parashikon dënim deri në 3 vjet burgim për thirrjen për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj.

- Fillimi zyrtar i hetimeve nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë për Krimet e Rënda në Dhjetor 2013, për individë organizatorë, financues dhe pjesëmarrës në konflikte jashtë vendit. Nga këto hetime u identifikuan si të dyshuar 13 individë nga të cilët u arrestuan nëntë dhe katër të tjerë u shpallën në kërkim ndërkombëtar. Në muajin Maj 2016 Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendim Nr. 58 datë 03.05.2016, shpalli fajtorë nëntë individë të akuzuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për veprat penale "*Rekrutimit të personave me qëllim kryerjen e veprimeve terroriste*", "*Nxitjes , thirrjes publike dhe propaganda për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste*", "*Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve*" të parashikuara nga nenet 231,232/a dhe 265 të Kodit Penal dhe i dënojë në total me 126 vite burg, të cilat variojnë për çdo individë nga 7 deri në 18 vite burg. Për katër individët e shpallur në kërkim ndërkombëtar procesi i gjykimit vazhdon në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.
- Krijimi i Drejtorisë së Antiterrorit, si përgjigje ndaj zhvillimeve të situatës në vend, rajon e më gjerë. Fakti që vendi është pjesëmarrës në koalicionin ndërkombëtar antiterror, si dhe ekspozimi ynë përballë kërcënimeve me natyrë terroriste kanë bërë të nevojshëm fuqizimin e kapaciteteve për luftën kundër terrorizmit.
- Miratimi i Strategjisë Kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe Planit të Veprimit 2016-2020 (***miratuar me VKM nr. 930 datë 18.11.2015***).

Rreziku ndaj interesave shqiptare brenda vendit mund të gjykohet si i ulët. Sidoqoftë, rreziku ndaj disa prej interesave të caktuara të huaja Brenda vendit, tregtare ose diplomatike, mund të gjykohet si më i lartë se sa niveli i përgjithshëm i kërcënimit.

Megjithëse, toleranca dhe pluralizmi janë elementë thelbësore të ndërtimit të shoqërisë shqiptare, janë evidentuar një numër i vogël incidentesh të vogla ndaj të cilëve kërkohet vëmendje e veçantë dhe në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat relevante.

**1.2.4. Masat për kontrollin e armëve dhe për parandalimin e rrezikut nga lëndët CBRN**

Qeveria shqiptare ka identifikuar si një nga kërcënimet e sigurisë së vendit dhe më tej, ekzistencën e rezervave të tepërta të fishekëve si edhe të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL). Shkatërrimi i tepricave të fishekëve është në rrugën e duhur në përputhje me Direktivat e Mbrojtjes për vitin 2015 dhe "Planin e Veprimit për shkatërrimin e fishekëve për 2015". Në Nëntor 2015, Ministria e Mbrojtjes mbylli procesin e demontimit të materialeve industriale dhe shpërthyese në mjedise të jashtme të përcaktuara, ndërsa procesi i tjetërsimit përmes shitjes pritet të përfundojë brenda vitit 2016.
Në përputhje me Vendimin e Këshillit të BE-së, të 9 Dhjetorit 2013, dhe të Strategjisë së BE-së për Luftën ndaj grumbullimit të paligjshëm, kursimit dhe trafikut të paligjshëm të Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) si edhe të fishekëve, Ministria e Mbrojtjes dhe Punëve të Brendshme në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP dhe SEESAC ngritën grupin e punës për Komitetin Ndër-Ministror për Armët e Vogla dhe të Lehta (SALW) në Republikën e Shqipërisë. Detyra kryesore është hartimi i Strategjisë Kombëtare të AVL dhe Planit respektiv të Veprimit. Ky komitet do të shërbejë si organ koordinimi institucional përgjegjës për politikat e zhvillimit, kërkimit, koordinimit, zbatimit dhe të monitorimit të përpjekjeve për parandalimin, luftën dhe eliminimin e posedimit dhe tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta, dhe trajtimin në nivel kombëtar të problemeve, pasojave dhe çështjeve të lidhura me të gjitha aspektet e AVL.

Policia e Shtetit Shqiptar ka krijuar në vitin 2015, regjistrin kombëtar elektronik për regjistrimin e të dhënave të të gjitha armëve të vogla dhe të lehta në vend.
Regjistri elektronik do të përmirësojë kapacitetet kombëtare në mënyrë efektive përsa i përket kontrollit të posedimit të të dhënave të sakta të armëve të vogla dhe armëve të lehta në vend. Përveç kësaj, krijimi i regjistrit elektronik do të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe ekspertizën e rajonit të Evropës Juglindore, për të luftuar trafikimin e paligjshëm, zotërimin e armëve të zjarrit, njëkohësisht reduktimit të kërcënimit të paqes, stabilitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Në fushën e kontrollit të eksporteve të materialeve dhe armatimeve ushtarake, Autoriteti Kombëtar Shtetëror për Kontrollin e Eksporteve (AKSHE) pranë Ministrisë së Mbrojtjes, po punon për të përgatitur listën ushtarake të përditësuar, në përputhje me Listën e Përbashkët Ushtarake të BE-së (të miratuar nga Këshilli më 17 Mars 2014) (armatimet e parashikuara nga Qëndrimi i Përbashkët i Këshillit 2008/944/CFSP në përcaktimin e rregullave të përbashkëta që përcaktojnë kontrollin e eksporteve të teknologjive dhe armatimeve ushtarake).

Përsa i përket Armëve të Shkatërrimit në Masë, autoriteti përgjegjës për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të

shkatërrimit në masë është AKSHE. Por vendi jonë nuk ka kapacitetet e duhura për mbrojtjen e popullsisë nga agjentët CBRN. KM me propozim të Ministrit të Mbrojtjes ka miratuar tashmë Grupin Ndër-institucional të Punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare ADM dhe planit respektiv të veprimit me anë të Urdhërit Nr.79, dt.12.05.2016.

Strategjia Kombëtare ADM do të bazohet në strategjinë e BE-së, e cila nënvizon rëndësinë e të vepruarit në mënyrë që të zgjidhen, parandalohen, frenohen, ndalohen dhe të eliminohen programet për shtimin e këtyre armëve. BE-ja, është e angazhuar në sistemin e traktateve shumëpalëshe, të cilat ofrojnë bazat ligjore dhe normative për të gjitha përpjekjet për mos shtimin e këtyre armëve. Politika e BE-së, është e angazhuar në zbatimin dhe universalizimin e normave ekzistuese të çarmatimit dhe të mos përhapjes. Politikat e BE-së, zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare në ndalimin e materialeve të zbërthyeshme të armëve bërthamore ose të pajisjeve të tjera bërthamore. BE-ja, do të asistojë vendet e treta në përmbushjen e detyrimeve të tyre të bazuara në konventat dhe regjimet shumëpalëshe.

## KREU II

## KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

### 2.1. Kuadri Ligjor Kombëtar

Rezoluta e KSOKB-së 1624 (2005), u kërkon të gjitha shteteve anëtare të ndalojnë me ligj frymëzimin për kryerjen e akteve terroriste dhe të mos lejojnë persona në territorin e tyre, për të cilët ka dyshime serioze se janë të akuzuar për kryerjen e veprave terroriste.
Gjithashtu, në vitin 2005 u miratua Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, e cili përcakton si vepra penale akte të caktuara që mund të çojnë në organizatë terroriste, provokim sidomos publik, rekrutimin dhe trajnimin; Konventa siguron forcimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në parandalimin e terrorizmit nëpërmjet politikave kombëtare parandaluese dhe modifikimin e marrëveshjeve ekzistuese të ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë.

Zhvillimet më të rëndësishëm në fushën e legjislacionit kombëtar janë ndryshimet në Kodin Penal, ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar, në të cilin janë shtuar dispozita dhe sanksione, me qëllim dënimin e autorëve të akteve terroriste dhe bashkëpunëtoreve të tyre si më poshtë:

- Në ligjin nr.9275, datë 16.9.2004 "Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, është ndryshuar neni 28, në të cilin parashikohen format e veçanta të bashkëpunimit të pjesëtarëve në organizata kriminale dhe terroriste.

- Në ligjin nr.9686, datë 26.2.2007 "Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, janë bërë ndryshimet e nevojshme. Të dyja këto ndryshime në KP mund të përfshihen tek pika e parë më sipër.
- Miratimi i ligjit nr.9086, datë 19.6.2003 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, është shtuar neni 230/a - "Financimi i terrorizmit". Financimi i terrorizmit ose mbështetja në çdo formë e tij dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm dhe me gjobë nga 5 milionë lekë deri në 10 milionë lekë (37.862 Euro-75.723 Euro).
- Miratimi i " Strategjisë së Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë", me ligjin nr.103, datë 31.07.2014, përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme.
- Miratimi i Strategjisë ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafiqeve dhe terrorizmit", e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.663, datë 17.07.2013, si dhe plani i veprimit, për zbatimin e kësaj strategjie.
- Miratimi i Dokumentit strategjik kombëtar "Për hetimin e krimit financiar", me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 27.10.2009.
- Miratimi i Ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i cili është në përputhje me kërkesat e rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Zbatimi i këtij ligji bëhet nga DPPPP (FIU), ndërsa administrimi i llogarive dhe aseteve të ngrira, sekuestruara, konfiskuara bëhet nga AAPSK.
- Miratimi i Ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar me Ligjin 157/2013, "Për masat kundër financimit të Terrorizmit", i cili rregullon parandalimin e pastrimit të parave dhe të produkteve që burojnë nga vepra penale, parashikon rregullat dhe procedurat e raportimit tek strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji, si dhe kompetencat e tyre.
- Miratimi i Ligjit nr.10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i cili zbatohet edhe për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie edhe për pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura.
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.44, datë 10.6.2009 "Për miratimin e rregullores "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". Qëllimi i tij është parandalimi i përdorimit të subjekteve të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, të cilët licencohen dhe/ose mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.140, datë 13.2.2008 "Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme të sekuestruara, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit".

- Rekomandimi i vendimit kuadër i KE-së, neni 5, dënimet - "Masat e ndëshkimit dhe dënimit të terroristëve", apo të nenit 2 të tij, për krimet e lidhura me grupet terroriste.
- Me ligjin nr.9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda", u krijua Gjykata për Krime të Rënda dhe Prokuroria për Krimet e Rënda, e cila ka në kompetencë edhe hetimin e veprave penale në fushën kundër terrorizmit.
- Ligji nr.10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".
- Ligji nr. 9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt", rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë.
- Ligji nr.10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale".
- Ndryshime në Kodin Penal të RSH-së, me ligjin Nr.98/2014, " Për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit të shtetasve shqiptarë".
- Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Plani i Veprimit 2016-2020, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015.

### 2.2. Instrumentet Ndërkombëtare Ligjore

- **Konventat dhe protokollet ndërkombëtare**

Republika e Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit në luftë kundër terrorizmit ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat dhe protokollet ndërkombëtare që përbëjnë instrumentet e së drejtës ndërkombëtare në fushën e antiterrorizmit. Shqipëria u është bashkuar iniciativave të OKB-së për të luftuar terrorizmin dhe ka ratifikuar tashmë 12 prej tyre. Krahas tyre ekzistojnë edhe një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së më vlerë detyruese për shtetet anëtare, si edhe konventa dhe protokolle të ashtuquajtura rajonale. Në këtë kuadër, Shqipëria aderon në të gjitha konventat dhe protokollet e Këshillit të Evropës kundra krimit të organizuar dhe terrorizmit (aktualisht 16 të tilla) dhe konkretisht:

1. "Konventa mbi Veprat Penale dhe Aktet e tjera të Kryera në Bordin Avionit", Tokio, 14.09.1963, ratifikuar me ligjin nr. 8197, datë 06.3.1999, Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.1997, faqe 52.
2. "Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme të Rrëmbimit të Avionit", Hagë, 16.12.1970, ratifikuar me ligjin Nr. 8197, datë 06.03.1997. Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.03.1997, faqe 52.
3. "Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil", Montreal, datë 23.09.1971, ratifikuar me ligjin nr. 8191, datë 06.03.1997. Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.03.997, faqe 52.

4. "Konventa mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave me Imunitet Ndërkombëtar, përfshirë Agjentët Diplomatikë", Nju Jork, 14.12.1973, ratifikuar me ligjin nr. 8832, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 56, datë 21.12.2001, faqe 1762.
5. "Konventa Evropiane mbi Shtypjen e Terrorizmit", Strasburg, 27.01.1979 ratifikuar me ligjin nr. 8642, datë 13.7.2000. Fletore Zyrtare nr. 22, datë 19.07.2000, faqe 1087.
6. "Konventa ndërkombëtare Kundër Marrjes së Pengjeve", Nju Jork 17.12.1979, ratifikuar me ligjin nr. 8837, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare 22, datë 19.07.2000, faqe 1087.
7. "Konventa mbi Mbrojtjen fizike të materialit bërthamor", Vjenë më datë 03.03.1980, ratifikuar me ligjin nr. 8853, datë 31.01.2002. Fletore Zyrtare 12, datë 08.02.2002, faqe 19.
8. "Protokolli Mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroport që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar", Montreal, 24.02.1991 ratifikuar me ligjin nr. 8835, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 56, datë 21.12.2001, faqe 1785.
9. "Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar", Romë, 10.03.1998, ratifikuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001. Fletore Zyrtare nr. 60, datë 31.12.2001, faqe 1886.
10. "Protokolli mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse, të Vendosura në Platformën Kontinental", Romë, 10.03.1988, ratifikuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001. Fletore Zyrtare nr. 60, datë 31.12.2001, faqe 1886.
11. "Konventa mbi Etiketimin e Eksploziveve Plastik për Qëllim Zbulimi", Montreal, 01.03.1991, ratifikuar me ligjin nr. 9020, datë 06.3.2003. Fletore Zyrtare nr. 21, datë 28.03.2003, faqe 649.
12. "Konventa Ndërkombëtare mbi Ndalimin e Bombardimeve Terroriste", Nju Jork, 15.12.1997, ratifikuar me ligjin Nr. 8836, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 57, datë 21.12.2001, faqe 1801.
13. "Konventa ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit" Nju Jork, 10.01.2000, ratifikuar nga parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 8865, datë 14.03.2002. Fletore Zyrtare, nr. 7, datë 05.04.2002, faqe 170.
14. "Konventa Europiane (Strasburgut), për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit", ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 20.7.2000. fletore Zyrtare, nr. 23, datë 04.08.2000, faqe 1183.
15. "Konventa e Këshillit të Europës, mbi pastrimin, kërkimin dhe konfiskimin e procedurave të krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit", datë 6.5.2005, nënshkruar me 22 dhjetor 2005, hyre ne fuqi me 1 Maj 2008.
16. "Konventa e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit", ratifikuar me ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006. Fletore Zyrtare nr. 134, datë 22.12.2006, faqe 5221.
17. Ratifikimi i "Protokollit ndryshues i konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit", ratifikuar me ligjin nr. 9230, date 13.5.2004. Fletore Zyrtare nr. 38, datë 16.06.2004 faqe 2793.

18. Për ratifikimin e "Konventës Europiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme" me ligjin Nr. 9265, datë 29.7.2004.
19. "Konventa Ndërkombëtarë për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Nuklear (Bërthamor) (2005) ", nënshkruar nga vendi ynë.

- **Marrëveshje dy palëshe në fushën e luftës kundër terrorizmit:**

Duke konsideruar se planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve terroriste është një proces i vështirë që rrallë herë ndodh brenda territorit të një vendi dhe në zbatim të Strategjisë Globale të OKB-së për Terrorizmin e cila kërkon bashkëpunim në nivel global, rajonal dhe kombëtar, në zbatim të rekomandimit të rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 49/60 (1995), Shqipëria ka marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me :

1. **Me Slloveninë-**Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar, nënshkruar me 24.11.1993, në Tiranë.
2. **Me Kroacinë-** Për bashkëpunimin policor, nënshkruar më 20 janar 2014.
3. **Me Egjiptin-** Protokoll mbi bashkëpunimi në fushën e luftës kundër terrorizmit, nënshkruar në Kajro, më 24.10.1995.
4. **Me Hungarinë-**Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar, nënshkruar në shkurt 1999 dhe ratifikuar me Ligjin nr. 8623, datë 15.06.2000.
5. **Me Rumaninë-**Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope, si edhe aktivitete të tjera ilegale, nënshkruar më 07.06.2002, në Bukuresht.
6. **Me Malin e Zi-**Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm si dhe veprimtarive të tjera të paligjshme", nënshkruar në Podgoricë, Mal i Zi, me 31 tetor 2003.
7. **Me Maqedoninë-**Mbi bashkëpunimin në luftën ndaj terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme, nënshkruar në Shkup, Maqedoni, më 17.06.2004.
8. **Me Bullgarinë-** Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale, nënshkruar në Tiranë, më 29 janar 2007.
9. **Me Francën-**Mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë së brendshme, nënshkruar në Paris, me 15.05.2008.
10. **Me Gjermaninë-** Mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë, nënshkruar më 31 Maj 2013 dhe ratifikuar me ligj më 23 Janar 2014.
11. **Me Bosnjë Hercegovinën-** Mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar, nënshkruar me 24.03.2009, hyrë në fuqi me 4.3.2010.
12. **Me Kosovën**-Mbi bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë. Miratuar me VKM nr. 429, datë 20.05.2015.

13. **Me Sllovakinë**-Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve të drogës dhe krimeve të tjera. Miratuar me VKM Nr. 485, datë 10.06.2015.
14. **Me SHBA-** Marrëveshje bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit. Ligji Nr. 72/2016.
15. **Me Serbinë-**Mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm ndërkombëtar të drogës dhe terrorizmit ndërkombëtar, nënshkruar më 11.03.2010, hyrë në fuqi më 01.03.2012.
16. **Me Letoninë-**Mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, nënshkruar më 16.12.2009.

### 2.3. Kuadri Institucional

Institucionet kryesore në luftën kundër terrorizmit janë si më poshtë:

**Policia e Shtetit**
Në përbërje të Policisë së Shtetit funksionon Drejtoria e Antiterrorit, me shtrirje strukturore në të gjithë territorin e vendit. Funksionet kryesore të Drejtorisë janë parandalimi, identifikimi, gjurmimi dhe hetimi i personave të dyshuar si të përfshirë në vepra terroriste.

**Shërbimi Informativ Shtetëror**
Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH), i krijuar me ligjin nr.8391, datë 28.10.1998, mbledh informacion nga jashtë në funksion të sigurimit kombëtar, kryen veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues, mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit, mbledh informacion për krimin e organizuar, krime që cenojnë sigurinë kombëtare.

**Prokuroria për Krimet e Rënda**
Prokuroria për Krimet e Rënda ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit për veprat penale në lidhje me terrorizmin. Gjithashtu, në Prokurorinë e Përgjithshme funksionon edhe Zyra e Përgjimeve të Komunikimeve Elektronike. Me memorandum të përbashkët ndërinstitucional, funksionojnë strukturat e hetimit të krimit financiar në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore - 8 njësitë e përbashkëta hetimore – të ngritur në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan e Gjirokastër.

**Ministria e Mbrojtjes**
Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në varësi të ministrit të Mbrojtjes funksionon bazuar në ligjin nr. 65/2014 "*Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së*

*Mbrojtjes"*. Ligji përcakton mënyrat e marrjes, administrimit dhe shpërndarjes së informacionit të klasifikuar kundër terrorizmit.

**Ministria e Financave**
Strukturat e saj:
Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit.

Drejtoria e përgjithshme e doganave (DPD) bashkëvepron me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të realizimit të misionit të saj për garantimin e sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit.
Agjencia e Administrimit të Aseteve Kriminale (AAPSK) për administrimin e fondeve dhe të pasurive të sekuestruara e konfiskuara.

**Banka e Shqipërisë**
Banka e Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve si autoritet mbikëqyrës, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**Ministria e Drejtësisë**
Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet strukturave të saj, siguron bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar apo kundër terrorizmit dhe financimit të tij, në zbatim të ligjit nr.10193, datë 3.12.2009 "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale".

## KREU III

## VIZIONI DHE MISIONI

### 3.1. Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie afatgjatë është ***"të zvogëlojë në maksimum rrezikun ndaj terrorizmit që lidhet me vendin dhe interesat tona, duke siguruar përmirësimin e elementëve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste"***.

Theksi për arritjen e këtij qëllimi do të vihet në parandalimin e akteve terroriste, duke përdorur një përgjigje të koordinuar nga shteti në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Çdo reagim duhet patjetër të marrë në konsideratë faktin se një sulm terrorist nuk mund të jetë i suksesshëm nëse ekzistojnë planet e parandalimit të sulmeve terroriste dhe strukturat e reagimit të shpejtë.

Për të arritur këtë objektiv, do të jetë e nevojshme që të evitohen dëmit nga aktet e mundshme terroriste dhe ekstremiste duke:

- Ndjekur sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme persona të përfshirë në terrorizëm.

- Mbrojtur zonat që janë shumë të rëndësishme për funksionimin e vendit dhe duke reaguar në mënyrë efektive në rastin e një incidenti.

Të parashikohen e përfundojnë aktet e nevojshme ligjore dhe normative për objektet e infrastrukturën kritike të vendit që mund të jenë objekt i sulmeve terroriste dhe që mund të sjellin pasoja të rënda për vendin. Për këtë fakt të parashikohen edhe rrugët për zgjidhjet e situatave që mund të lindin nga përgatitjet apo tentativat e mundshme terroriste.

### 3.2. Misioni

Misioni i kësaj strategjie është:

- Përcaktimi i prioriteteve, objektivave dhe aktiviteteve strategjike për parandalim dhe luftim të terrorizmit;
- Krijimi i kapaciteteve efikase dhe efektive për t'u ballafaquar me terrorizmin;
- Zhvillimi dhe fuqizimi i partneritetit në nivel global, rajonal dhe kombëtar në fushën e kundër-terrorizmit.

### 3.3. Angazhimet institucionale

**Ministria e Punëve të Brendshme**

- Të marrë përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim, si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji.
- Të grumbullojë planet e veprimit apo programet e punës të të gjithë institucioneve të tjera dhe t'i bëjë pjesë të kësaj strategjie. Për këtë të hapë një dosje të veçantë sipas standardeve, e cila të mbahet nga Drejtoria e Antiterrorit.
- Të ndjekë dhe marrë iniciativën për ripunimin e azhurnimin e strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.
- Ngritjen e kapaciteteve me burime njerëzore e logjistike të mirëtrajnuara kundër terrorizmit me qëllim parandalimin dhe goditjen e këtyre dukurive në Shqipëri.

- **Policia e Shtetit** – Është mekanizëm institucional në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre. Në përbërje të strukturave të Policisë së Shtetit funksionojnë:

- ***Drejtoria e Antiterrorit***-Të hartojë detyra që ndihmon në sigurimin e informacioneve dhe masave policore dhe procedurale për parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste.

- ***Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda***
- ***Drejtoria e Krimit Ekonomiko Financiar***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete strategjike në drejtim të përmirësimit ligjor dhe operacional të masave parandalimin dhe goditjen e individëve/grupeve të përfshirë në financimin e terrorizmit, si dhe shënjestrimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të tyre.
- ***Sektori i Krimeve Kompjuterike***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete strategjike në drejtim të përmirësimit ligjor dhe operacional të masave për parandalimin dhe goditjen e individëve/grupeve të përfshirë në krimin kibernetik.
- ***Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana***- Të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë partnere nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta kundër terrorizmit.
- ***Zyra Kombëtare Europol Tirana***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me agjencitë partnere të Europol nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta kundër terrorizmit.
- ***Drejtoria e Bashkëpunim Koordinimit Ndërkombëtar dhe Marrëdhënieve me Publikun***- Të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, administrativ edhe teknike të masave për bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.
- ***Drejtoria e Përgjithshme e Rendit dhe Sigurisë Publikë***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të zgjerimit dhe rritjes së aftësive të policimit në komunitet për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- ***Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të sigurisë në kufi, mbikëqyrjes së lëvizjes së qytetarëve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë si dhe armëve të shkatërrimit në masë.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile**-Të hartojë objektiva dhe aktivitete për identifikimin, monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve ndaj infrastrukturës kombëtare, si dhe përballimin e situatës në raste të ndodhjes së aktit terrorist.

**Ministria e Drejtësisë**-Të planifikojë objektiva dhe aktivitete për bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

- ***Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve***-Të planifikojë dhe zbatojë detyrat që lidhen me rritjen e sigurisë përreth individëve/grupeve të burgosurve për aktivitete që lidhen me ekstremizmin për të parandaluar ata nga rekrutimi i të burgosurve të tjerë.

**Ministria e Financave**-Të planifikojë dhe zbatojë detyrat që lidhen me aktet ligjore e normative sipas drejtimeve përkatëse të institucioneve në varësi, në funksion të parandalimit të akteve terroriste.

- ***Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave***-Të planifikojë objektiva dhe aktivitete si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit.
- ***Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara***-Të planifikojë detyra për administrimin e pasurive të sekuestruara të subjekteve të shpallura si financuese të terrorizmit, duke bllokuar burimet e të ardhurave të krijuara nëpërmjet tyre.
- ***Drejtoria e Përgjithshme e Doganave***-Të planifikojë detyra bashkëveprimi me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të garantimit të sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit.
- ***Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve***-Të planifikojë detyra për identifikimin e rasteve të pastrimit të parave, si dhe të krimeve në fushën ekonomike në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

**Banka e Shqipërisë**-Të planifikojë detyra për ushtrimin e funksioneve si autoritet mbikëqyrës, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**Ministria e Mbrojtjes**-Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të strategjisë për këtë institucion, sidomos në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në krijimin e kapaciteteve dhe aseteve ushtarake, për përdorim të integruar të tyre edhe nga institucionet e tjera shtetërore, si dhe për vënien e tyre në dispozicion të organizmave ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër terrorizimit.

- ***Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë Mbrojtjes***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete për përmirësimin e metodave teknike/speciale për grumbullimin, përpunimin, vlerësimin, analizimin, shpërndarjen e të dhënave, si dhe të produktit të inteligjencës gjithëburimshe për autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura dhe Forcat e Armatosura lidhur me kërcënime të natyrës së terrorizmit dhe ekstremizmit.

- ***Forcat e Armatosura***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete për ndërmarrjen e veprimeve operacionale në raste të incidenteve të ndodhura nga veprimtaria e akteve terroriste.
- ***Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve***-Të hartojë objektiva dhe aktivitete për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

**Ministria e Punëve të Jashtme**-Të ndihmojë me detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me homologët e huaj e organizatat ndërkombëtare.

**Ministria e Arsimit dhe Sportit** -Të hartojë detyra për hartimin, ndjekjen dhe zbatimin të kësaj strategjie duke u fokusuar: "Për luftën kundër fenomenit të ekstremizmit dhe radikalizmit në mjediset shkollore".

**Ministria e Mjedisit**-Të hartojë detyra për ndjekjen dhe të analizojë problemet mjedisore dhe vatrat e rrezikshme nga ku mund të vijnë pasoja infektive të rënda, duke informuar dhe marrë masat për eliminimin dhe parandalimin e përhapjes së pasojave.

**Ministria e Shëndetësisë**-Të hartojë detyra për ndjekje me përparësi funksionimin e sistemit të njoftimit, izolimit apo transportimit (të mostrave biologjike), si dhe analizimin e medikamenteve për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse me karakter të veçantë. Njëkohësisht të hartojë dhe ndjekë detyrat nëpërmjet zyrës së mbrojtjes nga rrezatimet.

- ***Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet***- është autoriteti kompetent kombëtar për mbrojtjen nga rrezatimet si dhe organi që rekomandon veprimet mbrojtëse për përballimin e emergjencave. KMR në bashkëpunim me IFB dhe DPE dhe nëpërmjet Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Rrezatimeve.
- ***Instituti i Fizikës Bërthamore***- siguron të gjitha shërbimet e nevojshme teknike dhe shkencore për monitorimin e situatave emergjente gjatë çdo lloj aksidenti radiologjik nëpërmjet skuadrave të tij të emergjencave në terren dhe në laborator si dhe nëpërmjet informacionit të siguruar nga Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Rrezatimeve.
- ***Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet***- mbikëqyr zbatimin e të gjitha rregullave dhe procedurave që lidhen me sigurinë në punën me burime të rrezatimeve jonizuese për shmangien e aksidenteve radiologjike.

**Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave** -Të hartojë detyra për ndjekje për monitorimin e masave ligjore e normative për parandalimin e përhapjes së rrezikut bioterrorist kryesisht efekteve të sëmundjeve të ndryshme me origjinë mjedisore.

**Prokuroria-** Institucion përgjegjës për hetimin, ndjekjen penale të terroristëve, ndëshkimin përfundimtar të tyre, konfiskimin e pasurisë dhe aseteve të fituara me anë të aktiviteteve terroriste.

**Shërbimi Informativ Shtetëror-** Të hartojë detyra për intensifikim të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit në fushën e terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në funksion të vendimmarrjes strategjike si dhe të paralajmërimit në kohë të organeve ligjzbatuese. Përgatitja periodike e vlerësimeve analitike mbi kërcënimin nga terrorizmi, radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm.
Thellim të marrëdhënieve të bashkëpunimit me shërbimet partnere dhe strukturat e sigurisë së NATO-s. Të vendosë dhe të mbajë bashkëpunim të përhershëm me strukturat e specializuara dhe të dedikuara të Policisë së Shtetit që merren me luftën kundër terrorizmit, si dhe me agjencitë e tjera ligjzbatuese në vend.

**Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes-**Të hartojë aktivitete dhe detyra për ndjekje për monitorimin e masave ligjore e normative për koncesione dhe privatizime në infrastrukturën e rëndësishme në vend.

**Ministria e Industrisë dhe Energjisë-**Të ndihmojë në planifikimin e detyrave për monitorimin dhe parandalimin e akteve terroriste ndaj infrastrukturës energjetike në vend.

**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë-**Të hartojë aktivitete mbi evidentimin dhe adresimin e problemeve në komunitet, si dhe të ndërhyjë për zgjidhjen e problemeve sociale, pasi një ndër arsyet e rekrutimit është dhe gjendja ekonomike e vështirë dhe niveli i ulët arsimor.

**Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës-**Të hartojë aktivitete për koordinimin dhe zbatimin e masave përkatëse të sigurisë për parandalimin akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në aviacionin civil, transportin rrugor, hekurudhor dhe portual. Të hartojë aktivitete në bashkëpunim me mekanizma të pushtetit lokal për parandalimin e akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në infrastrukturën e furnizimit me ujë të popullatës.

- ***Autoriteti Aviacionit Civil-***Të hartojë dhe të mbikëqyrë aktivitetet që lidhen me organizimin e sigurisë në aviacionin civil në zbatim të legjislacionit kombëtar në fuqi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Të ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil.
- ***Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor-*** Të hartojë aktivitete për ndjekjen dhe zbatimin e rregullave standarde të kontrollit, duke garantuar kryerjen e veprimtarisë se transportit rrugor të mallrave te rrezikshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi në përputhje me standardet evropiane.
- ***Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor -***Të hartojë aktivitete për ndjekje për forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e instalimeve kryesore, impianteve,

objekteve të rëndësishme dhe mjetet e transportit publik (trena) për parandalimin e akteve terroriste.

- *Forca e Sigurisë Portuale* -Të hartojë aktivitete për ndjekje për monitorimin e sistemeve elektronike të kontrollit të hyrjeve dhe daljeve të gjithë personave, si dhe sistemeve automatike të kontrollit të trafikut të mjeteve detare, që futen dhe dalin në territoret e porteve të Shqipërisë.

**Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore-**Të hartojë aktivitete për ndjekje për monitorimin përmes mekanizmave të pushtetit lokal, të ndihmojë në identifikimin e elementëve të cilët mund të çojnë në veprimtari terroriste dhe të marrë pjesë aktive në parandalimin dhe përgatitjen apo reagimin ndaj aktiviteteve terroriste.

**Komiteti Ndërinstitucional Kundër Terrorizmit-** Planifikon masa për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me luftën kundër terrorizmit.

**Sekretariati Teknik-**Planifikimi i masave për mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera, me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të këtyre informatave, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Komitetin Ndërinstitucional Kundër Terrorizmit.

## KREU IV

## POLITIKAT PRIORITARE

Politikat prioritare dhe objektivat që do të shërbejnë për një mbrojtje të mjaftueshme nga terrorizmi dhe në përputhje me 4 shtyllat e strategjisë së BE-së kundër terrorizmit janë:

**Parandalimi**: Ndalimi i radikalizmit dhe mbështetjes për terrorizmin dhe ekstremizmin
**Ndjekja**: Informacionet e përpunuara dhe hetimet që kryhen për të ndërprerë aktivitetet terroriste.
**Mbrojtja:** Të sigurohet që infrastruktura dhe interesat tona brenda dhe jashtë vendit janë të mbrojtura nga terroristët dhe ekstremistët.
**Reagimi**: Zbutja e efektit të sulmeve duke hartuar plane emergjencash për rastet e sulmeve terroriste, duke trajnuar punonjësit që do të reagojnë të parët dhe duke u siguruar që çdo reagim të jetë i koordinuar dhe i testuar.

### 4.1. Parandalimi

Ndalimi i radikalizmit dhe mbështetjes për terrorizmin dhe ekstremizmin;

- Ndërprerja e aktiviteteve të rrjeteve dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm.

- Angazhimi i komunitetit në kundërvënie ndaj mesazhit të ekstremizmit të dhunshëm.
- Mbështetja e individëve që gjykohet se janë ekspozuar ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit
- Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.
- Parandalimi i rrezikut nga lëndët CBRN (*Kimik, Bakteriologjik, Radiologjik dhe Bërthamor*)

### 4.2.Ndjekja

Informacionet e përpunuara dhe hetimet që kryhen për të ndërprerë aktivitetet terroriste.

- Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit.
- Masat e luftës kundër financimit të terrorizmit.
- Zvogëlimi i kërcënimit nga aktet e mundshme terroriste në vend, apo nëpërmjet vendit tonë.
- Bashkëpunimin në dimensionin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit.

### 4.3. Mbrojtja

Të sigurohet që infrastruktura dhe interesat tona brenda dhe jashtë vendit janë të mbrojtura nga terroristët dhe ekstremistët.

- Mbrojtja e infrastrukturës kritike të vendit.
- Parapërgatitja për menaxhimin e incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve CBRN(*Kimik, Bakteriologjik, Radiologjik dhe Bërthamor*).
- Të forcohen masat në kontrollin kufitar për personat dhe mallrat.
- Të forcojmë masat dhe infrastrukturën për mbrojtjen nga rreziku i sulmeve kibernetike.

### 4.4 Reagimi

Zbutja e efektit të sulmeve duke hartuar plane emergjencash për rastet e sulmeve terroriste, duke trajnuar punonjësit që do të reagojnë të parët dhe duke u siguruar që çdo reagim të jetë i koordinuar dhe i testuar.

- Të përmirësohen kapacitet e Emergjencave Civile dhe mekanizmat e reagimit të shpejtë pas ndodhjes së aktit terrorist.
- Shkëmbimi i informacionit në mënyrë të shpejtë duke siguruar koordinim me median për informimin e publikut.
- Përgjigja e shpejtë e Forcave të Armatosura në përballimin e situatës pas aktit terrorist.
- Reagimi efektiv në përgjigje të incidenteve ku përfshihen lëndët (CBRN).
- Dhënia e ndihmës ndaj të dëmtuarve nga akti terrorist.

## KREU V

## 5.1. PROCESI I MONITORIMIT DHE I VLERËSIMIT

Bazuar në VKM me Nr. 675 datë 06.07.2011 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2011-2015", me urdhër të Kryeministrit Nr.265 datë 09.12.2014 është krijuar dhe funksionon komitetit ndërinstitucional për bashkërendimin e veprimeve në luftën kundër terrorizmit.

Komiteti Ndërinstitucional për Bashkërendimin e Veprimeve në Luftën Kundër Terrorizmit do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin e kësaj strategjie.

Ministria e Punëve të Brendshme, nëpërmjet **Sekretariatit Teknik** (Drejtoria e Antiterrorit në Policinë e Shtetit) do të përgatisë buletinin vjetor, bazuar në raportimet që do të bëjnë institucionet e tjera duke kryer detyrat e mëposhtme:

- Të grumbullojë planet dhe informacionet periodike dhe detyrat e veçanta të të gjitha institucioneve të tjera;
- Të marrë iniciativën për ripunimin e azhurnimin e strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

Monitorimi i këtyre rezultateve do të jetë i brendshëm dhe i jashtëm.
Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë duke u mbështetur te indikatorët:

***Si indikatorë të brendshëm do të jenë:***
- shkatërrimi i grupeve kriminale të përfshira në këto aktivitete;
- sekuestrimi i pasurive të rrjedhura nga këto aktivitete të paligjshme;
- arrestimi i personave me karrierë kriminale;
- treguesit e tregut të paligjshëm;
- përdorimi i formave dhe mjeteve të veçanta të hetimit;
- paraqitja e një situate të sigurt në vend e standarde të mira të rendit.

***Si indikatorë të jashtëm do të jenë:***
- vlerësimet e publikut, të qytetarëve dhe të bizneseve të ndryshme nëpërmjet matjes së perceptimit të publikut duke përdorur pyetësorë, intervista dhe organizuar forume të hapura;
- vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, në raporte periodike apo buletine; vlerësimet e vendeve të rajonit për treguesit e minimizimit të krimit të terrorizmit në Shqipëri.

Të gjitha institucionet e tjera do të dërgojnë një raportim të plotë për masat e marra lidhur me implementimin e kësaj strategjie, si dhe strategjive të tjera në fund të çdo 6-

mujori në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duke shpjeguar dhe arritjet e realizuara nga implementimi i masave.
Qeveria do të marrë në analizë punën e institucioneve të përmendura në këtë strategji në drejtim të luftës kundër krimit të terrorizmit çdo vit, si dhe do të bëjë publike arritjet pas çdo faze të implementimit të objektivave e planeve të veprimit, si dhe pasqyrojë arritjet kundër krimit të terrorizmit.

## KREU VI

## 6.1. BURIMET FINANCIARE

Burimi i financimit për vënien në zbatim të kësaj strategjie, parashikohet nga buxheti përkatës i institucioneve që kanë detyrime dhe marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit.

Të gjitha institucionet e përfshira në këtë strategji, çdo vit gjatë procesit të hartimit të kërkesave buxhetore, duhet të planifikojnë përfshirjen në këto kërkesa të aktiviteteve dhe kostove përkatëse të parashikuara në planin e veprimit.

Shpenzimi i buxhetit të kësaj strategjie duhet të bashkërendohet në marrëveshje me të gjitha institucionet. Për këtë qëllim Komiteti Ndërinstitucional për bashkërendimin e veprimeve në luftën kundër terrorizmit, duhet të marrin përgjegjësi në lidhje me monitorimin e përdorimit të buxhetit.

Institucionet e përfshira në këtë strategji duhet të hartojnë projekte me qëllim thithjen e financimeve të BE dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtare.

Kosto e Përllogaritur e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit është 80.000.000 lekë, 2.100.000 Euro dhe 748.000$.

Kohëzgjatja e zbatimit deri në vitin 2020.
Në kosto nuk janë llogaritur kostot administrative dhe të projekteve që mund të përfitohen nga partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët në vend gjatë periudhës 2016-2020.

## KREU VII

## 7.1. PLANI I VEPRIMIT

PLANI I VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT 2016-2020

| I.MASAT ADMINISTRATIVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivat** | **Mënyrat e veprimit** | **Institucionet zbatuese** | **Afatet kohore** | **Kostot financiare dhe kush e mbulon** |
| I.1.-Studimi, Hartimi, Përgatitja dhe përqasja e legjislacionit sipas standardeve të BE, në lidhje me luftën kundër terrorizmit. | **I.2.1**- Do të ngrihet grupi i punës për analizim të mangësive të kuadrit ligjor për luftën kundër terrorizmit.<br><br>**I.2.2**- Hartimi i propozimeve për ndryshimet në legjislacion.<br><br>**I.2.3**- Hartimi i një ligji të plotë e sipas standardeve europiane për luftën kundër terrorizmit.<br><br>**I.2.4**-Hartimin procedurave standarde për koordinimin ndërinstitucional në menaxhimin e krizave pas një akti terroristë.<br><br>**I.2.5**-Do të hartohet e miratohet VKM për trajtim të veçantë ne fonde mjedise e mjete te nevojshme për strukturat kundër terrorizmit. | KM/MPB/MMb/MF/ MPJ/MZHETS/ME/ MMSR/SHISH/ PP | 3-mujor i II -2018 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. Kosto Administrative të parashikuara në PBA |
| **II.PARANDALIMI** | | | | |
| **Objektivat** | **Mënyrat e veprimit** | **Institucionet zbatuese** | **Afatet kohore** | **Kostot financiare dhe kush e mbulon** |
| **II.1**- Ndërprerja e aktiviteteve të rrjeteve dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm. | **II.1.1**- Do të implemetohet dhe zbatohen filozofia dhe programi i policimit në komunitet për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. | PSH/ICITAP | Dhjetor 2016 | Kosto e mbuluar nga MPB dhe Programi ICITAP dhe Agjencia Suedeze SIDA |
| | **II.1.1.a**- Identifikimi dhe miratimi i zonave gjeografike për implementimin e projektit pilot "policimi në komunitet". | PSH/ICITAP | 3-mujori i III- 2016 | |
| | **II.1.1.b**- Identifikimi dhe miratimi i punonjësve të policisë që do të marrin pjesë në trajnimin e specializuar me temë: "Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet". | PSH/ICITAP | 3-mujori i III- 2016 | |
| | **II.1.1.c**- Zhvillimi i trajnimit të specializuar me punonjësit e policisë me temë: "Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet". | PSH/ICITAP | 3-mujori i IV- 2016 | |
| | **II.1.1.d**- Implementimi i projektit "Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet" në zonat pilot të përcaktuara. | PSH/ICITAP | 3-mujori i III- 2016 | |
| | **II.1.1.ç**- Implementimi i projektit "Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet" në të gjithë vendin. | PSH/ICITAP | 3-mujori i IV- 2016 | |
| | **II.1.2**- Do të zhvillohen fushata | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | sensibilizuese si biseda, kumtesa, ekspozita me komunitetet shkollore të arsimit bazë dhe mesëm (mësues, nxënës dhe prindër).<br>**II.1.2.b.** MAS, përmes udhëzimit të vitit shkollor, do të orientojë DAR/ZA dhe Shkollat të hartojnë planin e punës për sensibilizimin e nxënësve, Mësuesve dhe Prindërve ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit. | MAS/DAR/ZA/ SHKOLLAT/OJQ/ Komiteti i kulteve | 2016-2020 | Kosto mbulohet nga MAS të parashikuara në PBA |
| | **II.1.3-**Do të përgatitë çdo vit një raport për evidentimin e shkaqeve dhe numrin e fëmijëve të mitur që nuk ndjekin arsimin e detyrueshëm 9-vjecar. | MAS/ DAR/ZA/ | 2016-2020 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve të parashikuara në PBA |
| | **II.1.4-**Do të rritet siguria përreth të burgosurve për aktivitete që lidhen me ekstremizmin për të parandaluar ata nga rekrutimi i të burgosurve të tjerë. | MD/DPBurgjeve | 2016-2020 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.1.4.a-**Të rrisë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën penitenciare për të siguruar ekspertizën e nevojshme për identifikimin e të burgosurve me sjellje ekstremiste/ radikale dhe të rrezikshëm<br>-Aplikimi në TAIEX për mision ekspertësh për vlerësimin e situatës në burgje.<br>-Aplikimi i një procedure të standardizuar për identifikimin e të burgosurve të rrezikshëm(*modeli Zoicerun*).<br>-Vizita studimore, shkëmbim eksperience në kuadër të projektit të binjakëzimit për reformën në sistemin e burgjeve me Mbretërinë e Bashkuar. | MD/DPBurgjeve | 2017-2019 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.1.4.b-**Të forcojë kapacitetet e stafit të burgjeve si dhe të adaptohen metodologji dhe udhëzime efikase për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit.<br>-Hartimi i metodologjisë për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit në sistemin e burgjeve në bashkëpunim të ngushtë me ekspertë të huaj anglez.<br>-Hartimi i udhëzimit për vënien në zbatim të metodologjisë për stafin e burgjeve për zbatimin në praktikë.<br>-Sesione pune me stafin e burgjeve. | MD/DPBurgjeve | 2016-2020 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.1.4.c-**Të përmirësohen programet edukuese për të burgosurit duke hartuar module të veçanta për tolerancën fetare, sjelljet ekstremiste, si dhe ofrimi i asistencës së veçantë për | MD/DPBurgjeve | 2016-2018 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | grupet vulnerabël në burgje ose më të prirur drejt radikalizmit dhe rekrutimit nga organizatat terroriste .<br>-Konsultimi me dokumente dhe praktika ndërkombëtare bashkëkohore.<br>-Hartimi i moduleve dhe konsultimi me partnerë bashkëpunues për zbatimin në praktikë në sistemin e burgjeve.<br>-Trajnimi i stafit për zbatimin në praktikë të modulit.<br>-Bashkëpunimi me OJQ për ofrimin e asistencës së specializuar për grupet vulnerabël nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.<br><br>**II.1.4.d**- Të ofrojë trajnime të specializuara për stafin e burgjeve, bashkëpunëtorët e jashtëm që operojnë në sistemin e burgjeve, duke përfshirë institucionet fetare për të identifikuar dhe parandaluar sjelljet ekstremiste.<br>-Hartimi i moduleve të trajnimit për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit.<br>-Përcaktimi i stafit të burgjeve dhe institucioneve bashkëpunuese që do të marrin pjesë në trajnime.<br>-Takime institucionale dhe procedurat administrative. | MD/DPBurgjeve | 2017-2020 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.1.4.e**- Të forcojë bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese dhe hetimore<br>-Vënia në dispozicion e formularit standard që praktikohet në sistemin e burgjeve për mbledhjen e informacionit të sigurisë.<br>-Ndërmarrja e iniciativave të përbashkëta për forcimin e kapaciteteve për parandalimin e sjelljeve ekstremiste. | MD/DPBurgjeve | 2016-2020 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.1.5**-Do të hartohen programe trajnimi të detyrueshme për punonjësit e vijës së parë për të identifikuar të rinjtë që janë rrezik për ekstremizëm dhe mënyrat se si duhet të veprojmë në raste të tilla. | MAS/MPB/MMSR/ PSH | 2016-2020 | Kosto administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.1.6**-Do të krijohet një linjë telefonike falas për komunitetit për të raportuar në mënyrë anonime lidhur me grupet individët që përhapin ide ekstremiste në komunitet. | MPB/PSH/ | 2016-2018 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| | **II.1.7**- Do të identifikohen dhe monitorohen websitet, links etj. | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | që propagandojnë ideologji ekstremiste për qëllime terroriste përmes internetit. | MIT/MPB/PSH/ SHISH/MMb/PP/ AISM. | 2016-2020 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| **II.2**-Angazhimi i komunitetit në kundërvënie ndaj mesazhit të ekstremizmit të dhunshëm. | **I.2.1**-Do të zhvillohen fushata në media sociale, programe televizive, radiofonike, për përhapjen e mesazhit kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. | KM/MPB/MAS/ MMSR/ Komiteti i kulteve | 2016 -2020 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| | **II.2.2**-Do të bashkëpunohet me bashkësitë e komuniteteve fetare që ato të përfshijnë në ligjërata apo predikime fetare që kundërshtojnë dhunën dhe promovojnë harmoninë fetare. | KM (Komuniteti i Kulteve) në bashkëpunim me bashkësitë fetare | **2016-2020** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. Kosto Administrative të parashikuara në PBA |
| | **II.2.3**-Do të ofrojnë trajnime për gazetarë e studiues se si duhen trajtuar ekstremizmi i dhunshëm. | KM (Komiteti i kulteve)/MPB/MAS MMSR/OJQ. | **2016-2018** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve të parashikuara në PBA |
| | **II.2.4**-Do të përgatiten broshura, fletë palosje, për informimin e të rinjve dhe komunitetit, mbi rrezikun e radikalizmit dhe ekstremizmit. | KM (Komiteti i kulteve)/MPB/MAS/ MMSR | **2016-2017** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| | **II.2.5**-Informim, trajnim dhe përfshirje aktive e grave, (sidomos atyre ne zonat rurale) ne jetën sociale e ekonomike, duke i konsideruar si elementi kryesor qe ndikon ne edukimin me fryme paqësore dhe konstruktive te rinise. | KM (Komiteti i kulteve)/MPB/MAS/ MMSR | **2016-2020** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve |
| **II.3**-Mbështetja e individëve që gjykohet se janë ekspozuar ndaj ekstremizmit dhe radikalizmit | **II.3.1**-Do të hartohen programe këshillimi psikologjike dhe fetare për individët e burgosur për veprimtari që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin si dhe ata dhe të kthyer nga vendet në konflikt. | KM (Komiteti i kulteve)/MPB/ MMSR | **2016-2020** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| | **II.3.2**-Do të hartohen skema për mbështetje sociale për individët dhe familjet e personave të burgosur të kthyer dhe të vrarë nga vendet në konflikt. | KM/MPB/ DPBurgjeve/MMSR | **2016-2020** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| | **II.3.3**-Do të hartohen programe sociale dhe punësimin për integrimin e individëve/grupeve të radikalizuar në vend. | KM/MPB/MMSR/ MÇV | **2016-2020** | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
| **II.4**-Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të | **II.4.1**-Do të bashkëpunohet në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për identifikimin e faktorëve që çojnë njerëzit drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. | KM/MPB/MMSR/ MPJ/ SHISH/ MMB | 2016-2018 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhunshëm. | **II.4.2**-Hartimi i protokolleve dhe sistemeve të ndarjes së informacionit për të mbledhur, sistemuar dhe ndarë të dhëna nga një gamë e gjerë burimesh, me qëllim që të mundësohen reagime dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë ndaj ekstremizmit të dhunshëm | KM/MPB/MMSR/ MMb/MF/MPJ/ SHISH/PP | 2016-2020 | Mbulohet nga buxheti i institucioneve. |
